



Njoftimi i përqendrimit me të cilin GRVC Holdings Limited (GRVC Holdings Limited), Qipro, dhe personi Boguslav Kovalski, shtetas i Republikës së Polonisë, do të fitojnë kontrollin e përbashkët mbi Gral S.A. (Graal S.A.), Poloni

(Lënda nr. 08-44 / 2016)

Në bazë të nenit 15 të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës (Gazeta Zyrtare nr. 145 / 10, 136/11 dhe 41/14), me datën 29.08.2016, Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës merr njoftimin e përqendrimit në lidhje me marrjen e kontrollit nga GRVC Holdings Limited (GRVC Holdings Limited), me seli në Prodromoy dhe Dimitrakopoyloy 2, kati 5 1090 Nokozija, Qipro, me z. Boguslav Kovalski, shtetas i Republikës së Polonisë, mbi shoqërinë Gral S.A. (Graal S.A.), me seli në rr. Yahodnia 22, 84-200 Vejherovo, Poloni nëpërmjet në shoqërie me qëllim të veçantë Grinviç Investments sp. z o.o. (Greenwich Investments sp. z o.o.), me seli në Aleje Jerozolimskie 56C, 00-803, Varshavë, Republika e Polonisë.

GRVC Holdings Limited, Qipro i takon Grupit Abris (Abris Group). Grupi Abris, i cili përbëhet nga fondet e investimit privat (equity funds) dhe kompanive të portofolit të cilët janë aktive në sektorë të ndryshëm. Grupi Abris është i pranishëm në tregun e Republikës së Maqedonisë drejtpërdrejt (nëpërmjet GRINTEH MK SHPK Shkup) dhe në mënyrë indirekte (nëpërmjet shitjeve në Republikën e Maqedonisë nga kompanitë e tij me seli jashtë shtetit). Në territorin e Republikës së Maqedonisë, Grupi Abris dhe shoqëria në tërësi janë të pranishëm në sektorë të ndryshëm dhe veprimtaritë e tyre të biznesit nuk përputhen.

Shoqëria për tregti, prodhim dhe shërbime GRINTEH MK SHPK Shkup 852 nr. 62, Shkup Republika e Maqedonisë me veprimtarinë: rikuperimin e materialeve të ndara veç e veç.

Gral S.A. (Graal S.A.), Poloni është një firmë nënë e Grupit Gral Kapital (Graal Capital Group), e specializuar në prodhimin dhe shpërndarjen e peshkut të konservuar dhe mishit, ushqim për drekë, peshk të ngrirë, havjar sallate të peshkut dhe produkte nga peshku losos i freskët dhe i tymosur.

Gral S.A. (Graal S.A.), Poloni nuk ka filiale të saja në Republikën e Maqedonisë.

Në aspektin e kontrollit të përqendrimeve, GRVC Holdings Limited, Qipro do të fiton kontrollin e përbashkët mbi Gral S.A. (Graal S.A) Poloni, së bashku me z. Boguslav Kovalski, aksionarit aktual në Gral S.A. (Graal S.A), Poloni.

Parashtruesit e njoftimit theksojnë se tregu relevant i produkteve në Republikën e Maqedonisë mund të mbetet i hapur në rastin konkret, sepse nuk ekzistojnë përputhje të tregjeve ndërmjet palëve. Në rast të miratimit të definicionit të



REPUBLIKA E MAQEDONISË
KOMISIONI PËR MBROJTJEN E KONKURENCËS

Rr. Shën Kirili dhe Metodi nr. 54 (kati i 6), 1000 Shkup
Tel (02) 3298 666 Faksi (02) 3296 466 www.kzk.gov.mk e-mail: kzk@kzk.gov.mk



tregut, duke marrë parasysh aktivitetet e Gral S.A. (Graal S.A) Poloni, tregu do të mund të përkufizohet si shitje me shumicë të peshkut të konservuar dhe prodhimeve tjera të detit në territorin e Republikë së Maqedonisë

Në bazë të shqyrtimit paraprak Komisioni konstaton se përqendrimi në shqyrtim mund të bie nën dispozitat e Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës. Megjithatë, vendimi përfundimtar për këtë çështje është i rezervuar.

Komisioni fton palët e treta të interesuara të paraqesin vërejtjet dhe mendimet në lidhje me këtë përqendrim Komisionit. Vërejtjet dhe mendimet e palëve të treta të interesuar mund të dërgohen edhe me faks: 02 3296 466, në adresën: rr. Shën Kirili dhe Metodi 54, Shkup ose me email: kzk@kzk.gov.mk dhe të njëjtat duhet të arrijnë në Komision në afat prej 10 ditëve nga dita e publikimit të këtij njoftimi.

05.09.2016
Shkup